



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data 26.03.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “SHERBIM I GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIMIT  
TE MBETJEVE URBANE NE BASHKINE BERAT**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të grumbullimit të mbeturinave- 90511000-2, Shërbime të transportit të mbeturinave- 90512000-9

**PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :**

Specifikimet teknike ,preventivi dhe metodologjia e shërbimit per proceduren respektive jane hartuar komisioni i ngritur me Urdher Kryetari **NR.84, DATË 31.01.2024 “PËR LLOGARITJEN E KOSTOS PËR GRUMBULLIMIN DHE TRANSPORTIMIN E MBETJEVE PËR NËNTË MUAJ, PËR BASHKINË BERAT”**.Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive. *Shenim : Ne rastet kur citohet ne specifikimet teknike termi “ Cilesia e pare”, ky percaktim eshte i barasvlefshem me termin “ ekuivalente”*.

VLERA E FONDIT LIMIT: 15 991 344 ( pesëmbëdhjetë milion e nëntëqindë e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e dyzete e katër) leke pa Tvsh,  
Komisioni i perlllogaritjes se fondit limit i ngritur me Urdher Kryetari NR.84, DATË 31.01.2024 ka punuar bazuar Ligjin nr.10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, VKM nr.319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve “, VKM nr.113, datë 1.3.2023 “ Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve tre viteve te fundit ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### BASHKIA BERAT

të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të VKM nr.285, datë 19.05.2021, nenin 43, pika 4 (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shenohen, vlera, afati i perfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

kerkesave te legjislacionit ne fuqi ku shenohen datat, shumat shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.1.** Operatori ekonomikë pjesëmarrës duhet të jete i pajisur me license leshuar nga QKL “Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve te ngurta “Kodi III. 2.B ” (Për grumbullim, ruajtje dhe transportin e mbetjeve te ngurta), së bashku me aktin e miratimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19 05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji”. Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: ‘Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon **licencën për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III. 2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërinjet Qendrës Kombëtare të Licencimit ( QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta ”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” : “ Veprimtaria e nënkategorisë III. 2. B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë si dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” ose ekuivalente
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, ose ekuivalente

*Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 14 (katërmbëdhjet ) punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shoferë	Persona	5
Punëtor makine për grumbullim mbetjesh	Persona	9

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

Kontratat e punës të vlefshme;  
Dëshmia e aftësisë profesionale për shoferat

*Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzoj pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:*

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin e fundit.*
- *Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit..*

*Ne rast se makinerit disponohen me kontrate qiraje dhe shoferat janë të kontraktuar ata nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesa*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**a) Shofer (5)**

Jane kërkuar 5 shofere sipas mjeteve qe duhet te disponoje operatori ekonomik nga zberthimi i metodologjise bashkengjitur dst.

**b) Puntore te thjeshte (9)**

Jane kërkuar 9 punonjes te thjeshte sipas zberthimit te preventivit ne metodologjine e hartuar nga komisioni i hartimit te specifikimeve teknike bashkengjitur dst.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Duke u nisur nga numri i makinerive te kerkuara makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se 2(dy) copë dhe makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak 2(dy) copë; [1 në punë dhe 1 rezervë] ne total prej 4 cope eshte perlllogaritur numri i shoferve qe duhet per kryerjen e ketij sherbimi, konkretisht 4 mjete duan 5 shofera per 360 dite pasi nje shofer eshte perlllogatur sipas kodit te punes te punoj jo me shume se 172 ore pune. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet.

Sipas metodologjisë së përdorur bazuar në legjislacionin në fuqi janë përlllogaritur që për 3 makineri duhen 6 punëtorë dhe 3 punëtor janë llogaritur plotësues

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës

**a.**Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se **2(dy) copë;**

**b.**Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak **2(dy) copë;**

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK*

*Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:*

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.*
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

- d) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.*
- e) *Makinat e transportit të shoqerohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emer të shoqerise apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Mjetet e kërkuara është i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës sipas specifikave të kërkuara.

**Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:**

*“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.” “ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik” Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.”Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se : “Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës.”*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

*Mjetet e kerkuara jane vendosur sipas metodologjise se sherbimit te hartuar nga komisioni per llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.*

**Mjetet e mesiperme jane kerkuar per grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane, te kerkuara per realizimin e kontrates**

**a.**Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se **2(dy) copë;**

**b.**Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak **2(dy) copë;** [1 në punë dhe 1 rezervë]

Duke u nisur nga metodologjia e sherbimit te pastrimit per territorin e Bashkise Berat jane perlllogaritur qe per kryerjen e ketij sherbimi jane te nevojshme makinerite e mesiperme me tonazh 5 ton/10ton. Perlllogaritja e koston se ketij sherbimi dhe kohen e caktuar jane kryer duke marre ne konsdierate makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se 2(dy) copë dhe makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak 2(dy) copë; [1 në punë dhe 1 rezervë]. Tonazhi prej 10 ton eshte perlllogaritur per zonen urbane ku gjenerimi i mbetjeve eshte me i larte dhe nr i kontenierëve eshte me i larte ne krahasim me zonat e tjera. Tonazhet prej 5ton janë përlllogaritur prej nr të kontenierëve më pak në zonat rurale, dhe në zonat urbane ku makinat me tonazh 10 tonësh nuk mund te futen. Tabelat bashkelidhur per argumentimin e tyre bazuar ne legjislacionin ne fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

NJESIA E PROKURIMIT

Specialist I fushes  
Klea Hajrullaj

Jurist  
Fjoralda Arapi

Specialiste (Ekon)  
Ardisa Zhuka

MIRATOHET  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
ERVIN DEMO